



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E FINANCIMIT TË ARSIMIT TË LARTË
BORDI DREJTUES

Nr. 173/4 Prot.

Tiranë, më 08.09.2025

VENDIM

Nr. 08 Datë 08.09.2025

PËR

"MIRATIMIN E MODELEVE TË MARRËVESHJEVE TRE-PALËSHE TË MBËSHTETJES FINANCIARE, SIPAS VKM NR.386/2022, PËR STUDENTËT E REGJISTRUAR NË VITIN AKADEMIK 2022-2023 TË CILËT PLOTËSOJNË KRITERET DHE NDJEKIN STUDIMET NË CIKLIN E DYTË"

Bordi Drejtues i Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë, mbështetur në nenin 11, dhe 112, të ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në Vendimin nr.397, datë 3.5.2017 të Këshillit të Ministrave "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL)", në Vendimin nr.386 datë 1.6.2022, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer e studentëve, që ndjekin këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë", në Udhëzimin nr.30, datë 04.11.2022, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit "Për përcaktimin e rregullave dhe afateve të aplikimit, si dhe të procedurave të përcaktimit të masës dhe mënyrës së financimit të studentëve të shkëlqyer dhe atyre që ndjekin programe studimi që përbëjnë prioritet kombëtar", si dhe në zbatim të Rregullores së Brendshme të Bordit Drejtues të AKFAL,

VENDOSI:

1. Miratimin e model marrëveshjes tre palëshe për studentët që ndjekin studimet në një program prioritar dhe që kanë nënshkruar marrëveshjen për ciklin e parë, të regjistruar në vitin akademik 2022-2023, të cilët plotësojnë kriteret dhe ndjekin studimet në ciklin e dytë në një program prioritar, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
 2. Miratimin e model marrëveshjes tre palëshe për studentët e shkëlqyer që kanë nënshkruar marrëveshjen për ciklin e parë, të regjistruar në vitin akademik 2022-2023, të cilët plotësojnë kriteret dhe ndjekin studimet në ciklin e dytë, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
 3. Ky vendim i përcillet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.
 4. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i AKFAL, për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI DREJTUES

KRYETARI
Erzen TOLA

ANËTARËT

Beqir M. JA

Artan HOXHA

Agron KAS

Spiro BRUMBULLI

Adresa: Rruga "Naim Frashëri", Nr.37, Tiranë, info.akfal@arsimi.gov.al